

Transformimi Digjital në Nivelin Lokal në Kosovë:

Roli i të Rinjve dhe përdorimi i Inteligjencës
Artificiale për qeverisje transparente

Dhjetor 2025

Transformimi Digjital në Nivelin Lokal në Kosovë:

Roli i të Rinjve dhe përdorimi i Inteligjencës
Artificiale për qeverisje transparente

Titulli: Transformimi Digjital në Nivelin Lokal në Kosovë:

Roli i të Rinjve dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale për qeverisje transparente

Botuar nga: Konrad Adenauer Foundation (KAS) in Kosovo

Design: Tedel (Faton Selani)

Qëndrimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos qëndrimet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Publikimi ka karakter informues dhe nuk lejohet të përdoret nga partitë politike apo nga kandidatët dhe mbështetësit e tyre për qëllime të fushatës elektorale.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	6
Hyrje	7
Kapitulli 1. Transformimi Digjital: Koncepti, Rëndësia dhe Nevoja	9
Kapitulli 2. Përdorimi i teknologjisë në nivelin lokal në Kosovë	17
Kapitulli III – Inteligjenca Artificiale për rritje të Transparencës në Nivel Lokal	23
Përfundime dhe Rekomandime	30
Referencat	32

Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim synon të trajtoj një nga sfidat dhe mundësitë më të mëdha të administratës publike në Kosovë: transformimin digjital dhe përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) për rritjen e transparencës, efikasitetit dhe përfshirjes qytetare në vendimmarrje, e me theks të veçantë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Qëllimi është të ofrohet një pasqyrë analitike mbi gjendjen aktuale të digjitalizimit në komunat e Kosovës, rolin e të rinjve në procesin e inovacionit publik dhe potencialin e IA-së për modernizimin e qeverisjes.

Në vitet e fundit, Kosova ka përparuar në ndërtimin e platformave qendrore si e-Kosova, duke bërë të mundur dhjetëra shërbime online për qytetarët. Por niveli lokal – ku qytetarët ndërveprojnë më shpesh me institucionet – mbetet pas në zbatim.

Në anën tjetër, popullsia e re, që përbën mbi 50 % të popullsisë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2024), është forca lëvizëse më e madhe për inovacion digjital që do të mund të arrihet përmes nismave “civic tech”, start-upeve lokale dhe ndërveprimit të sektorit publik me atë privat.

Ndër gjetjet kryesore të këtij punimi janë:

- Mungesa e një koherence strategjike në aspekt të digjitalizimit të shërbimeve në nivelin lokal,
- mungesë e pjesshme e transparencës së komunave karshi qytetarëve (vetëm një pjesë e tyre prezantojnë të dhënat e shpenzimeve)
- Potencial i pashfrytëzuar rinor – ndonëse rinia në Kosovë ka qasje dhe njohuri të mira të teknologjisë, komunat e Kosovës nuk arrijnë të përdorin këtë potencial në shërbim të rritjes së digjitalizimit të shërbimeve.
- IA si mundësi reale: për automatizim, analizë të buxheteve, përmirësim të ndërveprimit dhe rritje të transparencës (OECD, 2023; European Commission, 2024).

Në thelb, ky raport argumenton se transformimi digjital në nivelin lokal nuk është më vetëm çështje teknike, por politike dhe kulturore, që kërkon ndryshim të mënyrës së qeverisjes, bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe përfshirje të të rinjve në ndërtimin e shërbimeve publike.

Hyrje

Transformimi digjital nuk është më një prej opsioneve, ai është dshmuar si i domosdoshëm për epokën në të cilën jemi. Si proces i nxitur nga përdorimi gjithnjë e më i shpejtë e teknologjisë, ai mori rëndësi e hov sidomos gjatë periudhës së Covid-19, kur u pa nevoja për digjitalizim të proceseve si preventivë për përhapjen e pandemisë. Ndonëse i nisur shumë më parë, edhe për të rritur efikasitetin e punës, urgjenca e shkaktuar nga pandemia Covid-19 i dha një hov shtesë digjitalizimit dhe rëndësisë së tij.

Transformimi digjital dhe përdorimi i inteligjencës artificiale IA po shënojnë një nga ndryshimet më të mëdha strukturore në historinë moderne të shoqërisë njerëzore. Ajo që dikur ishte një debat mbi teknologjinë, sot është bërë realitet praktik që ndikon çdo aspekt të jetës — nga mënyra si qeveritë ofrojnë shërbime publike, tek mënyra si bizneset operojnë dhe si qytetarët ndërveprojnë me botën. Përdorimi strategjik i IA-së dhe automatizimit po e tejkalon kuptimin tradicional të “modernizimit” duke formësuar një model të ri zhvillimi që mbështetet në efikasitet, parashikim të nevojave, dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Shtetet që e kanë përqaftuar në kohë këtë proces — si Estonia, Danimarka apo Portugalia — kanë provuar se digjitalizimi nuk është vetëm çështje teknologjie, por një transformim kulturor dhe institucional që përmirëson transparencën, ul kostot dhe forcon lidhjen mes qytetarit dhe shtetit.

Në këtë kontekst, Kosova gjendet përpara një sfide dhe mundësie njëkohësisht. Ndërkohë që shumë vende evropiane po zbatojnë sisteme të avancuara të qeverisjes digjitale dhe po integrojnë inteligjencën artificiale në sektorë si arsimi, shëndetësia apo administrata publike, Kosova po bën hapat e parë drejt një transformimi të qëndrueshëm digjital. Investimet në infrastrukturë teknologjike, zhvillimi i platformave si e-Kosova, si dhe përpjekjet për integrim të IA-së në shërbimet publike janë sinjale pozitive, por procesi mbetet ende në faza fillestare të zhvillimit. Mungesa e strategjive të koordinuara, mangësitë në edukimin digjital (sidomos të zyrtarëve shtetëror) dhe kapacitetet e kufizuara institucionale janë faktorë që kërkojnë adresim për të mos mbetur pas në garën rajonale dhe evropiane.

Gjithsesi, potenciali është i madh. Kosova ka një popullatë të re, dinamike dhe të lidhur ngushtë me teknologjinë, që mund të shndërrohet në avantazh nëse orientohet drejt inovacionit dhe zhvillimit të zgjidhjeve digjitale. Përdorimi i inteligjencës artificiale mund të përmirësojë proceset administrative, të rrisë efikasitetin dhe të krijojë vende të reja pune në ekonomi të bazuara në dije. Në këtë kuadër, transformimi digjital nuk duhet parë si qëllim në vetvete, por si një mjet për të ndërtuar një shtet më transparent, më të drejtë dhe më konkurrues në rajon.

Kosova gjendet përpara një sfide dhe mundësie njëkohësisht. Ndërkohë që shumë vende evropiane po zbatojnë sisteme të avancuara të qeverisjes digjitale dhe po integrojnë inteligjencën artificiale në sektorë si arsimi, shëndetësia apo administrata publike, Kosova po bën hapat e parë drejt një transformimi të qëndrueshëm digjital.

Një ndër ndikimet më të rëndësishme të transformimit digjital lidhet edhe me fuqizimin e qytetarëve dhe mënyrën si ata marrin pjesë në proceset demokratike. Në një periudhë të përdorimit të shumtë të teknologjisë, është e nevojshme që edhe komunikimi qytetarë-institucion shtetëror t'i përshtatet atij.

Teknologjia, përfshirë platformat e pjesëmarrjes publike, konsultimet online dhe qeverisja e hapur, mund ta ofrojë qytetarin me institucionet më shumë se kurrë më parë.

Portale si e-Kosova, publikimi i të dhënave të hapura (open data) dhe përdorimi i inteligjencës artificiale për monitorimin e shpen-

zimeve publike janë hapa që mund ta forcojnë ndjeshëm këtë lidhje. Kur qytetarët kanë qasje të lehtë në informata, mundësi për të dhënë mendim dhe për të ndjekur në kohë reale vendimmarrjet, krijohet një kulturë e re pjesëmarrjeje — ku teknologjia nuk zëvendëson demokracinë, por e forcon atë duke e bërë më transparente, më të drejtë dhe më të afërt me njerëzit.

Në thelb, ky raport synon të analizojë gjendjen aktuale të transformimit digjital në komunat e Kosovës, të vlerësojë rolin e të rinjve në nxitjen e inovacionit publik lokal si dhe të hulumtoj mënyrat sesi IA mund të përdoret për qeverisje të hapur dhe efikase.



Transformimi Digjital: Koncepti, Rëndësia dhe Nevoja

1.1. Kuptimi dhe përmasat e transformimit digjital

Transformimi digjital është më shumë se modernizim teknologjik; është një proces ndryshimi strukturor, kulturor dhe institucional që ndikon mënyrën se si qeveritë ndërveprojnë me qytetarët dhe ofrojnë shërbime publike. Transformimi digjital në sektorin publik mund të konsiderohet edhe “adoptimi strategjik i teknologjisë për të rritur efikasitetin, transparencën dhe përfshirjen qytetare duke u bazuar në qasje të udhëhequra nga të dhënat”.

Në praktikë, transformimi digjital përfshin:

- dixhitalizimin e proceseve (kalimi nga formate fizike në elektronike);
- integrimin e sistemeve (ndërveprim ndërinstytucional);
- përdorimin e të dhënave për vendimmarrje;
- përfshirjen qytetare përmes platformave digjitale;
- sigurimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Nëse digjitalizimi është proces teknik, transformimi digjital është proces politik e organizativ, sepse kërkon ndryshim të kulturës së punës dhe mentalitetit burokratik (Gasco-Hernández, 2024). Në administratat moderne, kjo përfshin ndërthurjen e teknologjisë me leadershipin institucional, edukimin publik dhe rregullimin ligjor.

Në nivel lokal, ky transformim është veçanërisht i ndërlikuar: komunat kanë kapacitete më të kufizuara, por ndërveprojnë drejtpërdrejt me qytetarët. Prandaj, digjitalizimi lokal është shpesh barometri i besimit publik dhe i performancës së përgjithshme të qeverisjes.

1.2. Pse është i rëndësishëm për qeverisjen lokale dhe transparencën

Në kontekstin e Kosovës, transformimi digjital i komunave është faktor thelbësor për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies publike. Sipas Bankës Botërore (2024), përdorimi i teknologjive digjitale në financat publike lokale ul kostot administrative me dhe përmirëson saktësinë e raportimit financiar. Në të njëjtën linjë, Open Data Kosovo (2022) tregon se publikimi i të dhënave komunale në formate të hapura rrit ndërveprimin qytetar dhe besimin në institucionet lokale.

Përfitimet kryesore përfshijnë:

- Efikasitet dhe kursim kohe: qytetarët mund të marrin shërbime pa paraqitje fizike;
- Transparencë dhe përgjegjshmëri: vendimet, kontratat dhe buxhetet bëhen publike në kohë reale;
- Pjesëmarrje qytetare: platforma për konsultime publike e aplikacione për raportim problemesh forcojnë demokracinë vendore;
- Inovacion shërbimesh: përdorimi i mjeteve analitike ndihmon komunat të përshtatin politikatat ndaj nevojave lokale.

Për Kosovën, me një sektor publik të sfiduar shpeshherë nga mungesa e besimit publik, digjitalizimi mund të shërbejë si mjet për ndërtimin e integritetit dhe forcimin e lidhjes qytetar-institucion. Megjithatë, kjo kërkon një qasje të integruar ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.

1.3. Parimet udhëheqëse të qeverisjes digjitale

Transformimi digjital, për të arritur rezultate sa më të mira e të jetë në frymë demokratike, duhet të ndërtohet mbi parime themelore të mirëqeverisjes, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave, të përfshira edhe në dokumentet e BE-së dhe organizatave tjera kredibile:

- Qytetari në qendër (user-centric): shërbimet duhet të dizajnohen sipas nevojave të përdoruesit, jo strukturës së administratës (European Commission, 2021).
- “Digital by default”: shërbimet publike duhet të ofrohen në mënyrë digjitale si opsion parësor, me alternativa për grupet pa qasje digjitale.
- Operim të ndërveprueshëm dhe standarde të hapura: sistemet e komunave duhet të komunikojnë mes vete dhe me agjencitë qendrore, përmes standardeve të përbashkëta.
- Siguri dhe privatësi: mbrojtja e të dhënave personale është thelbësore për besimin publik.
- Transparencë algoritmike dhe etike: çdo përdorim i teknologjive të avancuara duhet të jetë i kuptueshëm dhe i gjurmueshëm për qytetarët (European Commission, 2024).
- Përfshirje gjithëpërfshirëse: digjitalizimi nuk duhet të thellojë pabarazitë ekzistuese, por t'i zvogëlojë ato përmes qasjes universale (OECD, 2023).

Nëse këto parime zbatohen në mënyrë të qëndrueshme, digjitalizimi bëhet instrument i demokracisë, jo vetëm i efikasitetit administrativ. Kjo nënkupton që shërbimet nuk modernizohen thjesht teknologjikisht, por ristrukturohen sipas nevojave reale të qytetarëve, duke ulur barrën burokratike dhe rritur transparencën. Qasja user-centric, ndërveprueshmëria, mbrojtja e të dhënave dhe transparenca algoritmike krijojnë një sistem ku qytetari trajtohet si palë e barabartë, jo si subjekt që duhet të përshtatet me sistemin. Sa më të harmonizuara të jenë këto parime, aq më i

vogël bëhet rreziku që inovacionet digjitale të prodhojnë përjashtim, pabarazi apo kontroll të panevojshëm. Në praktikë, kjo do të thotë administratë që merr vendime më shpejt, më drejtë dhe më hapur — duke e pozicionuar qytetarin në qendër të procesit.

1.4. Korniza evropiane: Digital Decade 2030 dhe Agjenda Digjitale Ballkanike

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, në Dhjetor 2022, kanë marr vendimin për themelimin e Programit të Politikës së dekadës digjitale 2023 (Digital Decade Policy Programme). Përmes këtij e dokumenteve tjera strategjike, Bashkimi Evropian, në vitet e fundit e kanë vendosur digjitalizimin si shtyllë të re të zhvillimit socio-ekonomik për dekadën 2020–2030. Dekada Digjitale 2030 (Digital Decade 2030), miratuar nga Komisioni Evropian përkufizon katër objektiva strategjike:

- aftësi digjitale për 80 % të popullsisë;
- infrastruktura e sigurt dhe lidhje 5G për të gjithë;
- dixhitalizim i plotë i institucioneve publike;
- bizneset të adoptojnë teknologji të avancuara si AI e cloud (European Commission, 2021).

Kosova, megjithëse jo anëtare e BE-së, është përfshirë në Agjendën Digjitale të Ballkanit Perëndimor, të mbështetur nga BE dhe RCC (2021). Kjo agjendë synon harmonizimin e politikave kombëtare me standardet evropiane, zhvillimin e kapaciteteve digjitale dhe ndërtimin e një tregu të përbashkët digjital rajonal.

Në këtë kuadër, raportet e ndryshme konfirmojnë se Kosova ka avancuar në ndërtimin e platformave digjitale kombëtare (si e-Kosova), por ka vonesa në nivelin lokal, sidomos në unifikimin e standardeve të të dhënave dhe në ndërtimin e kapaciteteve për siguri kibernetike.

1.5. Shembuj evropianë të praktikave të mira

Për të kuptuar rrugën që duhet ndjekur, është e dobishme të analizohen modelet që kanë arritur rezultate të matshme.

Estonia përfaqëson modelin më të suksesshëm global të një shteti që ka arritur ta ndërtojë qeverisjen digjitale si pjesë thelbësore të identitetit të tij kombëtar. Platforma X-Road, e cila është shtylla e gjithë sistemit digjital, mundëson ndërlidhjen e mbi 900 institucioneve publike dhe private, duke lejuar shkëmbimin automatik dhe të sigurt të të dhënave në kohë reale. Kjo infrastrukturë ka eliminuar burokracinë klasike, ka rritur transparencën dhe ka ulur ndjeshëm korrupsionin, pasi çdo ndërveprim i qytetarit me shtetin lë gjurmë elektronike të verifikueshme. Për shembull, lindjet regjistrohen automatikisht në sistem pa pasur nevojë për paraqitje fizike, ndërsa recetat mjekësore, taksat dhe regjistrimet e pronës kryhen të gjitha online përmes ID-së digjitale personale të çdo qytetari.

Një tjetër element kyç i suksesit të Estonisë është koncepti i “qytetarit digjital” (e-Residency), që u mundëson edhe jo-banuesve të krijojnë biznese dhe të menaxhojnë transaksione në BE pa qenë fizikisht në territorin estonez. Deri në vitin 2024, mbi 100,000 persona nga 170 vende kanë aplikuar për statusin e e-Resident, duke kontribuar në ekonomi përmes taksave dhe inovacionit digjital (Estonian e-Governance Academy, 2024). Ky program ka zgjeruar ndikimin e Estonisë përtej kufijve të saj, duke e pozicionuar si një qendër globale për start-up-e dhe sipërmarrje të bazuara në teknologji.

Për më tepër, qeveria estoneze ka investuar në edukimin digjital dhe sigurinë kibernetike si baza të transformimit të qëndrueshëm. Që nga arsimi fillor, nxënësit mësojnë programim dhe përdorim të sigurt të internetit, ndërsa qeveria operon një nga sistemet më të avancuara të mbrojtjes kibernetike në Evropë. Pas sulmeve kibernetike të vitit 2007, Estonia krijoi Qendrën e Ekselencës për Mbrojtje Kibernetike të NATO-s në Tallinn, duke u bërë lider në ndër-

timin e qëndrueshmërisë digjitale. Kjo qasje gjithëpërfshirëse — që kombinon infrastrukturën teknologjike, kornizën ligjore, arsimin dhe sigurinë — ka bërë që Estonia të konsiderohet sot si shteti me administratën me digjitale në botë, me 99% të shërbimeve qeveritare të qasshme online.

Portugalia ka ndërtuar një nga iniciativat më gjithëpërfshirëse të modernizimit administrativ në Evropë përmes programit SIMPLEX, i cili ka nisur në vitin 2006 dhe është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme (SIMPLEX+, SIMPLEX 2021, etj.). Ky program synon të thjeshtojë proceset burokratike, të ulë kostot administrative dhe të përmirësojë përvojën e qytetarëve dhe bizneseve në ndërveprim me administratën publike. Përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe eliminimit të dokumentacionit të panevojshëm, SIMPLEX ka reduktuar mbi 200 procedura administrative dhe ka krijuar një kulturë të re të efikasitetit publik. Një shembull konkret është projekti “Nascer Cidadão” (Lind si Qytetar), që lejon regjistrimin e fëmijës në maternitet menjëherë pas lindjes, pa pasur nevojë për vizita të mëvonshme në zyrat e gjendjes civile.

Një tjetër shembull domethënës është “Empresa na Hora” (Biznesi për një orë), një platformë që mundëson regjistrimin e një kompanie brenda pak minutash, krahasuar me disa javë që kërkoheshin më parë. Kjo masë ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e sipërmarrjes, veçanërisht për start-up-et dhe bizneset e vogla e të mesme. Për më tepër, qeveria portugeze ka integruar platformën ePortugal, e cila funksionon si një “one-stop shop” digjital për të gjitha shërbimet publike — nga aplikimet për dokumente identiteti deri te deklaratat tatimore dhe licencat e ndërtimit. Kjo ka ndihmuar që qytetarët të kursejnë kohë, ndërsa administrata të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar.

Rezultatet janë të dukshme: sipas Komisionit Evropian, programi SIMPLEX ka rritur kënaqësinë e qytetarëve, ka përmirësuar transparencën dhe ka ndihmuar në forcimin e besimit ndaj institucioneve publike. Portugalia

Estonia përfaqëson modelin më të **suksesshëm** global të një shteti që ka arritur ta ndërtojë qeverisjen digjitale si pjesë thelbësore të identitetit të tij kombëtar. Platforma X-Road, e cila është shtylla e gjithë sistemit digjital, mundëson ndërlidhjen e mbi **900 institucioneve publike dhe private**, duke lejuar shkëmbimin automatik dhe të sigurt të të dhënave në kohë reale.

është tashmë një nga vendet më të vlerësuara në indekset evropiane për qeverisje digjitale, duke konfirmuar se digjitalizimi nuk ka të bëjë vetëm me teknologjinë, por me një ndryshim kulturor në mënyrën se si shteti komunikon dhe bashkëvepron me qytetarin. Përmes SIMPLEX, Portugalia ka treguar se thjeshtimi administrativ është po aq i rëndësishëm sa inovacioni teknologjik në vetvete — një model që shumë vende të BE-së e kanë nisur ta ndjekin.

Danimarka ka implementuar parimin “digital by default”: çdo komunikim zyrtar me shtetin kryhet në mënyrë elektronike përmes portalit qendror borger.dk, i cili shërben si pika unike e aksesit për shërbimet publike, dokumentet personale, praktikatat tatimore dhe komunikimin me administratën lokale e qendrore. Kjo qasje e detyrueshme për të gjithë qytetarët dhe bizneset ka krijuar një administratë që funksionon pothuajse tërësisht online, pa dokumente fizike dhe pa procedura të panevojshme, duke e bërë Danimarkën një nga vendet më të digjitalizuara në botë.

Sipas OECD (2023), ky standard ka reduktuar ndjeshëm kostot operative të shtetit, ka shkurrtuar kohën e përpunimit të kërkesave dhe ka kursyer qindra miliona euro në vit përmes eliminimit të komunikimit fizik dhe menaxhimit manual të dokumenteve. Integrimi i platformave si NemID dhe tashmë MitID ka krijuar një sistem identifikimi të sigurt, që garanton verifikim të fortë për çdo ndërveprim digjital — nga nënshkrimet elektronike deri te aksesimi i të dhënave personale.

Mbi këtë bazë, Danimarka ka ndërtuar një kulturë administrative ku efikasiteti kombinohet me transparencën: qytetari ka qasje të menjëhershme në shërbime, ndërsa shteti monitoron më lehtë proceset dhe përgjigjet më shpejt ndaj kërkesave. Përtej kursimeve financiare, modeli danez ka treguar se digjitalizimi i plotë i komunikimit me administratën nuk është vetëm çështje teknologjike, por transformim rrënjësor i mënyrës se si shteti e koncepton marrëdhënien me qytetarin — duke e bërë procesin publik më të qartë, më të drejtëpërdrejtë dhe më të aksesueshëm.

1.6. Faktorët e suksesit dhe pengesat tipike

Në nivel ndërkombëtar, hulumtimet e OECD (2023) dhe Bankës Botërore (2024) tregojnë se transformimi digjital funksionon vetëm kur vendet ndërtojnë një vizion të qartë politik, krijojnë institucione të koordinuara me mandatat të prerë dhe investojnë në infrastrukturë moderne me standarde të ndërveprueshme. Edukimi dhe trajnimi i shërbyesve civilë luajnë rol vendimtar, po ashtu edhe përfshirja e qytetarëve në dizajnimin e shërbimeve — sepse sistemi digjital nuk mund të jetë efektiv nëse nuk pasqyron realitetin e përdoruesve.

Megjithatë, këto analiza theksojnë se progresi shpesh pengohet nga mungesa e financimit të qëndrueshëm, varësia nga projekte afatshkurtra të donatorëve dhe fragmentimi institucional që krijon “silo” të ndara të të dhënave.

Kosova ka një nga popullsitë **më të reja** në Evropë – **rreth 50 % e qytetarëve** janë **nën moshën 30 vjeç** (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2024). Ky realitet demografik

krijon një avantazh unik: të rinjtë zotërojnë aftësi të avancuara teknologjike, kreativitet dhe fleksibilitet për të drejtuar transformimin digjital.

Rezistenca e brendshme e administratës ndaj ndryshimit dhe kapacitetet e kufizuara për sigurinë dhe privatësinë e të dhënave e zbehin edhe më shumë efektin e çdo iniciative digjitale.

Në Kosovë, sipas vlerësimeve të MAPL (2023) dhe UNDP Kosovo (2025), shumica e këtyre pengesave janë të pranishme dhe shpesh shfaqen në mënyrë të përsëritur në çdo nivel të administratës. Pjesa më e madhe e iniciativave digjitale mbeten të kufizuara në eksperimente pilot të mbështetura nga donatorët, që funksionojnë përkohësisht dhe zakonisht nuk integrohen në sistemin institucional pasi projekti përfundon. Kjo krijon një realitet ku shërbimet digjitale janë të fragmentuara, me standarde të ndryshme, me platforma që nuk komunikojnë mes vete dhe me kapacitete teknike që lihen në pritje të fazës së radhës së financimit nga jashtë.

Në nivel praktik, mungesa e buxheteve të qëndrueshme për mirëmbajtje dhe zhvillim të platformave digjitale e bën të pamundur që komunat t'i përditësojnë shërbimet sipas nevojave reale të qytetarëve. Fragmentimi institucional vazhdon të pengojnë ndërveprueshmërinë, ndërsa kultura e rezistencës brenda administratës e ngadalëson çdo hap drejt digjitalizimit të proceseve të brendshme. Kapacitetet për siguri kibernetike — sidomos në nivel lokal — mbeten minimale, gjë që rrit rrezikun operacional dhe kufizon besimin e qytetarëve në shërbimet online.

Megjithatë Kosova ka tashmë zhvilluar platforma të mirë qëndrore si e-Kosova, e cila po përditësohet rregullisht me shërbime të reja që rrisin transparencën e shkurtojnë procedurat administrative, duket që mungon zinxhiri i brendshëm institucional që garanton funksionim të unifikuar nga ministritë deri te komunat. Pa standarde të përbashkëta, pa koordinim strategjik dhe pa investim serioz në njerëz dhe procese, digjitalizimi nuk do të arrij synimin e caktuar, atëherë transformimi do të shërbimet ndaj qytetarëve ofrohen.

1.7. Roli i të rinjve në procesin e transformimit digjital

Kosova ka një nga popullsitë më të reja në Evropë – rreth 50 % e qytetarëve janë nën moshën 30 vjeç (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2024). Ky realitet demografik krijon një avantazh unik: të rinjtë zotërojnë aftësi të avancuara teknologjike, kreativitet dhe fleksibilitet për të drejtuar transformimin digjital.

Programet e UNICEF Kosovo (2021) dhe UNDP Kosovo (2022) kanë treguar se kur të rinjtë përfshihen në bashkë-krijimin e aplikacioneve digjitale për komunat – si në rastin e projekteve *Techstitution* dhe *Digital Skills for Local Governance* – rezultatet janë konkrete: rritje transparence, përmirësim shërbimesh dhe zhvillim i aftësive profesionale.

Në shumë komuna, të rinjtë kanë kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e portaleve të ankesave online, aplikacioneve për monitorimin e buxhetit komunal dhe nismave të “open data” që i bëjnë të dhënat publike më të qasshme dhe të përdorshme. Ky angazhim nuk modernizon vetëm shërbimet, por forcon edhe kapitalin social dhe ndërtimin e besimit ndërmjet brezit të ri dhe institucioneve, sepse të rinjtë nuk mbesin vetëm konsumues pasivë të shërbimeve, por bashkë-krijues të tyre.

Në nivel strategjik, integrimi i të rinjve në transformimin digjital kërkon që ata të përfshihen në mënyrë sistematike në politikat komunale të inovacionit, të kenë qasje në programe të qëndrueshme trajnimi dhe praktikash profesionale në fushën e IT-së publike dhe të mbështeten përmes krijimit të Laboratorëve Rinorë të Inovacionit Digjital (Digital Youth Labs) në çdo rajon. Këta laboratorë, të mbështetur nga MAPL dhe partnerët ndërkombëtarë, do ta kthenin energjinë dhe kreativitetin rinor në kapacitete konkrete institucionale, duke e lidhur më ngushtë transformimin digjital me nevojat dhe vizionin e brezit të ri.

1.8. Përmbledhje

Transformimi digjital është një proces politik dhe shoqëror, jo vetëm teknologjik. Ai kërkon qasje të unifikuar ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, investim në njerëz dhe rritje të besimit publik përmes transparencës. Kosova ka nisur këtë rrugë përmes platformave qendrore dhe projekteve pilot komunale, por mungon ende korniza strategjike kombëtare që ta orientojë procesin në mënyrë të koordinuar. Roli i të rinjve është i pazëvendësueshëm: ata janë agjentët natyralë të ndryshimit digjital, dhe përfshirja e tyre sistematike do të garantojë që shërbimet publike të mos jenë vetëm digjitale, por edhe të përshtatura për qytetarët e shekullit XXI.

Pa një kornizë të qartë kombëtare, digjitalizimi rrezikon të zhvillohet në mënyrë të pabarabartë, ku disa sektorë dhe komuna ecin përpara, ndërsa të tjerat mbesin prapa. Platformat qendrore mund të funksionojnë teknikisht mirë, por nëse nuk ka standarde të unifikuara, mjetet të mjaftueshme financiare dhe ekipe të trajnuara në nivel lokal, shërbimet digjitale nuk do të jenë një lehtësim real për qytetarin. Po ashtu, pa rregulla të forta dhe kapacitete për siguri kibernetike dhe mbrojtje të të dhënave, çdo problem teknik ose rrjedhje informacioni e dëmton direkt besimin publik dhe e bën më të vështirë adoptimin e shërbimeve online.

Një qasje serioze ndaj transformimit digjital në Kosovë do të duhej të lidhte qartë vizionin politik në nivel qendror me kapacitetet konkrete në nivel lokal dhe me rolin aktiv të të rinjve. Kjo do të nënkuptonte planifikim afatgjatë, buxhetet të qëndrueshme, koordinim real ndërmjet institucioneve dhe përfshirje të qytetarëve në dizajnimin e shërbimeve. Vetëm nëse këto elemente punojnë së bashku, shërbimet publike digjitale mund të shihen nga qytetarët si mjet që u kursen kohë, ulen stresin administrativ dhe rrit llogaridhënien e institucioneve, jo si një formë tjetër burokracie e veshur me teknologji.

**Përdorimi i
teknologjisë në nivelin
lokal në Kosovë**

Në praktikë, funksionimi i administratës lokale dominohet ende nga **strukturat tradicionale burokratike**, me ndërlidhshmëri të lartë me ministritë për burime dhe mbikëqyrje ligjore. Kjo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e komunave për të zbatuar projekte digjitale, pasi shumë prej tyre **nuk kanë njësi të specializuara për ICT** ose personel të trajnuar në menaxhimin e të dhënave (UNDP Kosovo, 2025).

2.1. Funksionimi i Administratës Lokale në Kosovë

Sistemi i qeverisjes lokale në Kosovë është ndërtuar mbi parimin e vetëqeverisjes lokale të përcaktuar nga Ligji Nr. 03/L-040, i cili garanton autonomi organizative, financiare dhe administrative për 38 komunat e vendit. Komunat kanë kompetenca në fusha kyçe si arsimi fillor dhe i mesëm, shëndetësia primare, mbrojtja e mjedisit, planifikimi hapësinor dhe zhvillimi ekonomik lokal (MAPL, 2023).

Në praktikë, funksionimi i administratës lokale dominohet ende nga strukturat tradicionale burokratike, me ndërlidhshmëri të lartë me ministritë për burime dhe mbikëqyrje ligjore. Kjo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e komunave për të zbatuar projekte digjitale, pasi shumë prej tyre nuk kanë njësi të specializuara për ICT ose personel të trajnuar në menaxhimin e të dhënave (UNDP Kosovo, 2025).

Digjitalizimi në nivel komunal në Kosovë po zhvillohet me ritme të pabarabarta dhe shpesh pa një qasje të përbashkët strategjike. Hulumtimet tregojnë se disa komuna më të mëdha kanë avancuar në krijimin e shërbimeve elektronike – si aplikime online, pagesa digjitale apo raportimi i problemeve në terren – kryesisht falë mbështetjes së projekteve të financuara nga partnerët ndërkombëtarë (D4D, 2025). Megjithatë, një numër i madh komunash më të vogla vazhdojnë të mbeten prapa për shkak të mun-

gesës së kapaciteteve teknike, stafit të trajnuar dhe fondeve të brendshme për zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemeve digjitale.

Në nivel qendror, problemet strukturore janë po aq evidente. Analizat e fundit theksojnë se sistemet ekzistuese shpesh nuk komunikojnë mes vete, se ka mangësi të vazhdueshme teknike dhe se investimet në infrastrukturë dhe trajnime janë të pamjaftueshme për të mbështetur një transformim digjital të qëndrueshëm (FOL, 2024). Po ashtu, niveli i ulët i përdorimit të shërbimeve online nga qytetarët tregon se sfida nuk është vetëm teknike, por edhe kulturore dhe organizative.

Kur këtyre pengesave u shtohet fakti që shumica e komunave nuk planifikojnë buxhete të rregullta për zhvillim dhe mirëmbajtje, del qartë se digjitalizimi mbetet kryesisht i varur nga projekte të përkohshme të donatorëve. Kjo prodhon një proces të fragmentuar, të paqëndrueshëm dhe të ekspozuar ndaj ndërprerjes sapo përfundon financimi, duke e penguar ndërtimin e një arkitekture të qëndrueshme dhe funksionale të shërbimeve publike digjitale.

2.2. Infrastruktura teknologjike dhe investimet

Infrastruktura teknologjike është parakusht për çdo proces digjital. Sipas Agjencisë së Ko-

munikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP, 2024), mbulimi me rrjet broadband në Kosovë ka arritur mbi 97 % në nivel kombëtar, por cilësia dhe shpejtësia ndryshojnë ndjeshëm midis komunave urbane dhe atyre rurale. Komunitetet e mëdha, si Prishtina, Peja, Prizreni dhe Ferizaj, kanë qasje në serverë të dedikuar dhe infrastrukturë cloud, ndërsa komunitetet më të vogla përdorin shpesh zgjidhje bazë, pa kopje rezervë apo siguri të të dhënave (UNDP Kosovo, 2025).

Në shumë raste, sistemet komunale funksionojnë në mënyrë të izoluar ("stand-alone"), pa komunikim me bazat qendrore të të dhënave, gjë që pengon analizën dhe raportimin e të dhënave. OECD (2023) thekson se mungesa e interoperabilitetit është një nga pengesat strukturore më të zakonshme në administratat në tranzicion.

Në Kosovë, kjo mungesë shkëmbimi të të dhënave mes komunave dhe ministrive krijon dyfishim të informacionit dhe rrit mundësitë për gabime administrative. Në aspektin e investimeve komunat e Kosovës investojnë shumë më pak në shërbime të ICT sesa mesatarja e vendeve të BE-së (raporti në % të buxhetit). Për pasojë, komunat shpesh fokusohen në mbulimin e nevojave bazë (hardware, mirëmbajtje), jo në inovacion digjital apo trajnime të stafit.

2.3. Shërbimet kryesore digjitale ekzistuese

Platforma kombëtare e-Kosova (lansuar në 2021) ofron mbi 100 shërbime online në nivel qendror (Qeveria e Kosovës, 2024). Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e shërbimeve komunale mbeten të padigjitalizuara, ndonëse ky është një proces në vijim e me rezultate konkrete të shpeshta, edhe pse të ngadalshme karshi dinamikave globale.

Sipas vlerësimeve, jo të gjitha komunat kanë portale funksionale që lejojnë ndërveprim dypalësh (p.sh. aplikim, ndjekje statusi, pagesë

online). Për një kohë të gjatë, komunat nuk kanë pasur portale bazë funksionale ndërsa edhe tash, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk i përditësojnë të dhënat në kohë reale.

2.4. Transparenca dhe qasja në informacion

Transparenca është një nga dimensionet ku digjitalizimi mund të ketë ndikimin më të drejtpërdrejtë. Ligji për Qasje në Dokumente Publike (Nr. 06/L-081) detyron publikimin proaktiv të dokumenteve si buxhetet, kontratat dhe vendimet komunale. Megjithatë, organizatat e ndryshme raportojnë se zbatimi i tyre është i pjesshëm. Vetëm disa komuna publikojnë rregullisht dokumentet kryesore në faqet e tyre, dhe në shumë raste ato publikohen në formate PDF jo të lexueshme për analizë.

Përfundime pozitive janë komunat që bashkëpunojnë me OJQ-të lokale për publikim të hapur të të dhënave. Këto iniciativa kanë rritur interesin e qytetarëve dhe kanë përmirësuar monitorimin e llogaridhënies, por mbeten të kufizuara në shkallë.

Në një nivel më të gjerë, transparenca digjitale kërkon jo vetëm teknologji, por kulturë institucionale të hapur. Për këtë, zyrtarët e lartë komunal, duhet të kenë vullnet për punë transparente ndaj qytetarëve dhe raportim në kohë reale. Kjo do të rriste pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje dhe angazhimin e tyre për një qeverisje më efikase.

2.5. Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave

Rritja e përdorimit të teknologjisë në administratën publike shoqërohet me rreziqe të reja për sigurinë e informacionit. Rritja e përdorimit të teknologjisë në administratën publike ka ekspozuar institucionet ndaj një spektri gjithnjë e më të gjerë rreziqesh kibernetike. Analizat e sigurisë tregojnë se institucionet publike

në Kosovë përballen rregullisht me sulme si phishing, malware, ransomware dhe tentativa për komprometim të sistemeve qeveritare (KCSS, 2024). Për më tepër, vërehet një rritje e incidenteve që synojnë infrastrukturën kritike dhe platforma të ndryshme institucionale, duke përfshirë edhe nivelin lokal, si rezultat i dobësive teknike dhe kapaciteteve të kufizuara për reagim (DCAF, 2022). Këto sfida theksojnë nevojën për rritje të investimeve në siguri kibernetike, standardizim të procedurave, dhe përgatitje më të mirë të stafit administrativ për të menaxhuar incidente dhe për të mbrojtur të dhënat publike.

Shumë komuna nuk kanë personel të specializuar në siguri kibernetike.

Kjo situatë kërkon një qasje të menjëhershme dhe më të strukturuar ndaj sigurisë kibernetike, e cila të forcojë kapacitetet institucionale për menaxhimin e incidenteve, të krijojë mekanizma funksionalë të reagimit në nivel rajonal dhe të sigurojë integrimin real të komunave në arkitekturën kombëtare të mbrojtjes digjitale. Aktualisht, Kosova ka miratuar Strategjinë për Sigurinë Kibernetike 2023–2027, por fokusi i saj mbetet kryesisht në institucionet qendrore, duke lënë hapësira të mëdha të pambuluara në nivel lokal.

Pa shtrirjen e këtyre mekanizmave të komunat — të cilat menaxhojnë një numër të madh shërbimesh publike dhe procese administrative — digjitalizimi nuk mund të jetë as i qëndrueshëm dhe as i besueshëm. Rritja e kapaciteteve profesionale, standardizimi i procedurave të reagimit dhe qasja e koordinuar ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal janë thelbësore për të ndërtuar një infrastrukturë digjitale që i reziston rreziqeve dhe që krijon besim te qytetarët.

2.6. Kapacitetet njerëzore dhe kultura organizative

Një nga faktorët më kritikë në transformimin digjital është aftësia njerëzore për ta përqafuar ndryshimin. Në shumicën e komunave, departamentet e teknologjisë përbëhen nga 1–2 zyrtarë që fokusohen në mirëmbajtje, jo në inovacion. Në shumë raste, projektet digjitale varen nga një individ i vetëm, çka krijon varësi institucionale dhe rrezik vazhdimësie.

Një pjesë e madhe e zyrtarëve lokalë nuk kanë marrë trajnim formal për përdorimin e platformave digjitale, ndërsa shumë prej tyre kanë mungesë të udhëzimeve të qarta për përdorimin e të dhënave. Në shumë komuna, frika nga gabimet teknike ose përgjegjësia ligjore ndikon që zyrtarët të shmangin iniciativat digjitale. Kjo nënvizon nevojën për udhëheqje transformuese që motivon stafin dhe vendos kultura të reja pune të bazuara në inovacion, transparencë dhe bashkëpunim.

2.7. Pjesëmarrja e të rinjve dhe aftësitë digjitale

